



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
KOMISIONI I ANKIMIT TË ISHPSHSH-SË

Nr. 1383 / Prot. 13

Tiranë, më 27.12, 2024

Lënda: Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së

SUBJEKTIT: “BORICI KONSTRUKSION” SH.P.K ME NIPT M41429508Q

Adresa: Lagj. Nr.11, Rr. “Skendebe”, Durrës

Për dijeni: DREJTORISË QËNDRORE TË ISHPSHSH-SË, TIRANË

Bazuar në pikën 2 të nenit 51 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimit për vendimin Nr.ISHPSHSH-DQ-2024-000200-5 datë 31.10.2024 të subjektit “Borici Konstruksion”, Komisioni i Ankimit i ngritur pranë ISHPSHSH-së, pasi shqyrtoi kërkesën tuaj ankimore mbi dënimin administrativ kryesorë “gjobë” në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë për shkelje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010” Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, Neni 6, Pika 1 gërma c, si edhe dy paralajmërimeve për shkelje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010” Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, Neni 11 Pika 1 gërma a dhe Vendimi Nr. 132, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, pjesa B, seksioni 1, pika 5.13, si dhe detyrave të lëna për tu realizuar në afate kohore respektive, në mbështetje të parimit të proporcionalitetit si dhe në mbështetje të procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes së komisionit:

VENDOSI:

1. **Lënie në fuqi** të vendimit përfundimtar Nr. ISHPSHSH-DQ-2024-000200-5 datë 31.10.2024 mbi dënimin administrativ kryesorë “gjobë” në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë dhe rrëzimin e ankimit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas legjislacionit në fuqi.

KRYEINSPEKTOR

Eljo Muçaj